

## TERMET DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMIT TË HISTORISË SË VETURËS

### Dispozitat hyrëse

Këto Terme dhe Kushte të Përgjithshme për përdorimin e shërbimit të historisë së veturës (tutje referuar si "Termet dhe Kushte") rregullojnë marrëdhënien e biznesit ndërmjet Carvago by Gjirafa L.L.C. (tutje referuar si "Operatori") si operatori ekskluziv i shërbimit të Historisë së Veturës (tutje referuar si "Shërbimi") dhe cilitdo do person që përdor këtë shërbim (tutje referuar si "Përdoruesi"). Shërbimi i ofron Përdoruesit një përmbledhje të informacionit të disponueshëm për një veturë të caktuar dhe informacionet e nevojshme për një kontroll bazë të identifikuesve të tij. Të gjitha informacionet që i jepen Përdoruesit janë vetëm informative dhe ato nuk përfshijnë asnjë të dhënë që do të kualifikohen si të dhëna personale.

### Neni 1 - Definicionet

**"Operatori"** nënkupton Carvago by Gjirafa L.L.C. që vepron si operator ekskluziv i shërbimit të historisë së veturave.

**"Përdoruesi"** nënkupton personin që përdor Shërbimin e Historisë së Veturës.

**"Raporti i historisë së veturës"** nënkupton rezultati i kontrollit të veturës në pjesën e paguar të Shërbimit.

**"ID e raportit"** nënkupton një kod që i jep Përdoruesit qasje në pjesën e paguar të Shërbimit.

### Neni 2 - Shërbimi i Historisë së Veturave

Shërbimi i historisë së veturave është i qasshëm për Përdoruesin nëpërmjet faqes së internetit në [www.auto-tracer.com](http://www.auto-tracer.com) njëzet e katër (24) orë në ditë, me përjashtim të ndërprerjeve teknike afatshkurtra të nevojshme për mirëmbajtjen e rregullt të Shërbimit. Përdoruesi shënon një VIN (numër identifikues i veturës) të veturës për të kërkuar kontrollimin. Qasja në të dhënat e kontrollit të veturës është shërbim me pagesë sipas çmimit të vendosur në faqen e internetit i vlefshëm në datën e aplikimit të përdorimit të këtij Shërbimi. Përdoruesi ka të drejtë të përdorë informacionin e dhënë në tërësi vetëm për vete. Shpërndarja dhe/ose modifikimi i mëtejshëm i informacionit pa pëlqimin e Operatorit është e ndaluar.

### Neni 3 - Përdoruesit dhe qasja

Shërbimi është i ndarë në një seksion pa pagesë dhe në një seksion me pagesë. Seksioni pa pagesë është i qasshëm për këdo që ka qasje në internet dhe kjo e lejon Përdoruesin për të gjetur informacione të disponueshme për veturën në pyetje. Seksioni me pagesë bën të mundur qasjen në të gjitha informacionet e disponueshme. Qasja në seksionin e paguar të Shërbimit kushtëzohet me vendosjen e një ID Raporti. Shërbimi lejon qasjen - për një periudhë tridhjetë (30) ditore pas blerjes së

Shërbimit. Përdoruesi mund të shënojë vetëm një (1) kod VIN për një (1) kontroll automjeti.

### Neni 4 - Llojet dhe fushëveprimi i informacioneve Raporti i historisë së veturës:

Shërbimi i ofron Përdoruesit një përmbledhje të historisë së veturave me informacione të disponueshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në historikun e odometrit, vitin e prodhimit, të dhënat e shërbimit, regjistrimet e dëmeve, kontrollimin e veturës në një bazë të dhënash të veturave të vjedhura, kontrollin e financimit dhe informacione të nevojshme për një kontroll të identifikuesve të veturës. Shtrirja e informacionit të dhënë nuk është e njëjtë për vetura të ndryshme dhe mund të mos jetë e njëjtë edhe gjatë kërkimeve të njëpasnjëshme, kjo mund të aplikohet edhe në rastet e kërkimit të veturës së njëjtë. Shtrirja e informacionit që ofrohet gjithmonë varet nga disponueshmëria e tij në kohën e kërkimit dhe është specifikuar në përmbledhjen e informacionit në dispozicion të shfaqur në seksionin pa pagesë të Shërbimit.

### Neni 5 - Origjina dhe besueshmëria e informacionit të dhënë

Përdoruesi pranon që:

(a) Operatori punon me Partnerët e tij për të ofruar sa më shumë informacione rreth veturave të kërkuara. Partnerët, në bazë të aktivitetit profesional të tyre, punojnë me informacione rreth veturës që korrespondojnë në sasi dhe natyrën e përmbajtjes së Shërbimit dhe angazhohen t'ia sigurojnë këtë informacion Operatorit në mënyrë të vazhdueshme. Këta partnerë janë kryesisht kompani nga fusha e servisit të veturave, tregtarët e veturave, kompanitë e lizingut, kompanitë e sigurimit dhe të tjera kompani që operojnë në industrinë e veturave.

(b) Operatori informon Përdoruesin se informacioni i dhënë si pjesë e Shërbimit është ofruar nga Partnerët e Operatorit, duke pamundësuar kështu Operatorin për të verifikuar plotësinë dhe saktësinë maksimale prej njëqind përqind (100) % të tyre dhe obligimin që Operatori është i detyruar t'i mbajë këto të dhëna konfidenciale. Bazat e të dhënave përditësohen vazhdimisht në varësi të bashkëpunimit me partnerët e Operatorit. Operatori nuk është përgjegjës për ndonjë gabim ose lëshim në të dhënat e ruajtura në bazat e të dhënave të Shërbimit, e as për paplotësinë e tyre. As Operatori dhe as partnerët e tij nuk do të jenë përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga Përdoruesi ose palët e treta drejtpërdrejt ose tërthorazi për shkak ose në lidhje me përdorimin e Shërbimit.

(c) Verifikimi i identifikuesve të veturave duke përdorur informacionin e dhënë si pjesë e pagesës së Shërbimit nuk garanton që vetë vetura të mos ndikohet nga çdo ndryshim i paligjshëm i identifikuesve të veturave nga një palë e tretë.

### Neni 6 - Mbështetja e klientit

Përdoruesit e autorizuar të Shërbimit mund të kontaktojnë dhe të konsultohen me Shërbimin ndaj klientit në këtë email adresë: [autotracer@gjirafa.com](mailto:autotracer@gjirafa.com). Shërbimi ndaj klientit është i disponueshëm gjatë ditëve të punës nga ora 8:00 e mëngjesit deri në 16:30 pasdite CET.

## Neni 7 - Pagesa

Pagesa për Shërbimin bëhet në mënyrë elektronike nëpërmjet internetit.

## Neni 8 - Zbritja

Nëse Përdoruesi ka një kod zbritjeje, ai/ajo mund ta përdorë atë kur bën një blerje. Kodet e zbritjes me një periudhë vlefshmërie të kufizuar ose kode zbritje të skaduara nuk mund të rimbursohen nga Operatori. Nëse Përdoruesi ka bërë një pagesë për Shërbimin pa përdorur një kod zbritje, edhe pse Përdoruesi ka një të tillë, Operatori nuk është përgjegjës për pagesën e plotë të çmimit nga Përdoruesi. Përdorimi i njëkohshëm i kodeve të shumta të zbritjes për blerjen e Shërbimit nuk është i mundur. Nuk është e mundur të aplikohet një zbritje për një Shërbim tashmë në zbritje dhe nuk është e mundur të kërkohej një zbritje për blerjen e Shërbimit për të cilin asnjë zbritje nuk është e mundshme/disponueshme.

## Neni 8 - Përpunimi i të dhënave personale dhe komunikimi

Auto-tracer ofron produkte dhe shërbime që përshtaten vazhdimisht me nevojat e tregut të veturave, duke respektuar privatësinë e klientëve të saj në masën më të madhe të mundshme. Duke dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale dhe komunikimit, Auto-tracer mund të ofrojë produkte dhe shërbime të personalizuar. Kjo ka për qëllim identifikimin e nevojave përkatëse dhe ofrimin e ofertave dhe komunikimit të përshtatshëm. Të dhënat personale që do të përpunohen bazuar në këtë pëlqim përfshijnë kontaktin me email, informacionin që identifikon Përdoruesin ose pajisjen nga e cila Përdoruesi qaset në Shërbim, të tilla si IP adresat ose identifikuesit e cookie-s. Ky pëlqim jepet vullnetarisht nga Përdoruesi dhe mund të revokohet në çdo kohë, në mënyrën e treguar në reklamë ose me shkrim në adresën e selisë së Auto-tracer by Gjirafa. Përdoruesi pajtohet dhe e pranon këtë. Përdoruesi më tej pranon se pavarësisht mungesës së pëlqimit të shprehur këtu, Auto-tracer ka të drejtë të dërgojë mesazhe reklamuese duke ofruar produktet dhe shërbimet e veta për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh pas blerjes së Shërbimit, deri në momentin kur Përdoruesi paraqet mospajtim/kërkesë për revokim.

Informacione të mëtejshme në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga Auto-tracer përcaktohen në Politikën e Privatësisë dhe të Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Versioni aktual i këtij dokumenti është i disponueshëm në [www.auto-tracer.com](http://www.auto-tracer.com).

## Neni 9 - Dispozitat përfundimtare

(a) Termet dhe Kushtet e Përgjithshme janë të vlefshme dhe efektive në datën e publikimit në [www.auto-tracer.com](http://www.auto-tracer.com). Formulimi i Termave të Përgjithshme dhe Kushteve mund të ndryshoj herë pas here, me kusht që formulimi të jetë i vlefshëm që është rënë dakord nga Përdoruesi duke bërë një urdhër dhe pagesë detyruese për Shërbimin.

(b) Përdoruesi në cilësinë e konsumatorit ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata e lidhur në distancë brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga data e lidhjes së kontratës, përkatësisht nga momenti kur kryen pagesën për Shërbimin. Përdoruesi në cilësinë e konsumatorit duhet t'i kërkojë shprehimisht Operatorit që të ofrojë Shërbimin brenda afatit që e lejon ligji të tërhiqet nga kontrata, pasi Operatori e ofron normalisht Shërbimin brenda kësaj

periudhe. Nëse Shërbimi i është ofruar Përdoruesit nga Operatori brenda kësaj periudhe, Përdoruesi nuk ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata gjatë kësaj periudhe. Çdo e drejtë tjetër e përdoruesit për t'u tërhequr nga kontrata do të mbetet e paprekur, e pandikuar nga dispozitat këtu.

(c) Në marrëveshjet kontraktuale zbatohet ligji i Republikës së Kosovës.

(d) Mosmarrëveshjet eventuale në lidhje me këto Terme dhe Kushte fillimisht do të jenë objekt shqyrtimi nga të dy palët duke synuar arritjen e zgjidhjes. Në mungesë të zgjidhjes, përpara fillimit të procedurës gjyqësore, çdo mosmarrëveshje mund të zgjidhet në mënyrë jashtëgjyqësore. Në rrethana të tilla, përdoruesi është i autorizuar të angazhohet me një subjekt të caktuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësore, duke përfshirë metodat alternative të zgjidhjes së kontesteve.

(e) Në rast se nuk mund të gjendet ndonjë zgjidhje e pranueshme për palët, për çdo mosmarrëveshje, mospajtim, ose pretendim i dalur nga, apo i lidhur me këto Terme dhe Kushte, duke përfshirë shkeljen, ndërprerjen ose pavlefshmërinë e tyre, atëherë kompetent për zgjidhjen e tyre do të jetë Tribunali i Arbitrazhit i Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës. Tribunali i Arbitrazhit do të përbëhet nga një (1) arbitër ndërsa gjuha e arbitrazhit do të jetë gjuha shqipe.

Këto Kushte dhe Terme të Përgjithshme u publikuan më 1 Maj 2024 dhe janë të vlefshme dhe efektive që nga ajo datë.

**Informacione të mëtejshme mund të gjenden në:**

[www.auto-tracer.com](http://www.auto-tracer.com)

Verzioni: Maj 2024

**Carvago by Gjirafa L.L.C.**

Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM6,  
10500 Graçanicë, Kosovë,  
NUI: 812112887

[www.auto-tracer.com](http://www.auto-tracer.com),

e-mail: [autotracer@gjirafa.com](mailto:autotracer@gjirafa.com)